

V E N D I M
Nr. 215, datë 16.5.2002

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT NEGOCIATOR SHQIPTAR PËR
PËRGATITJEN E NEGOCIATAVE ME KOMISIONIN EUROPIAN DHE SHTETET
ANËTARE TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË
STABILIZIM-ASOCIIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 dhe 29 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8847, datë 19.12.2001 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002” me propozimin e Ministrit të Shtetit për Integrimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për ngritjen e grupit negociator shqiptar për përgatitjen e negociatave me Komisionin European dhe shtetet anëtare të Bashkimit European për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

2. Grupi negociator shqiptar përbëhet:

Ministri i Shtetit për Integrimin	kryenegociator
Përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve Jashtme	zëvendëskryenegociator
Dy përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme	anëtarë
Dy përfaqësues të Ministrisë së Financave	anëtarë
Dy përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë	anëtarë
Dy përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë	anëtarë
Dy përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale	anëtarë
Dy përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit	anëtarë
Dy përfaqësues të Ministrisë së Rendit Publik	anëtarë
Dy përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	anëtarë
Dy përfaqësues të Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës	anëtarë
Dy përfaqësues të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit	anëtarë
Dy përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	anëtarë
Dy përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit	anëtarë
Një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë	anëtar
Një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës	anëtar
Një përfaqësues i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	anëtar
Një përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes	anëtar
Një përfaqësues i Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit	anëtar
Një përfaqësues i Departamentit të Administratës Publike	anëtar
Një përfaqësues i Agjencisë së Prokurimit Publik	anëtar
Një përfaqësues i Institutit të Statistikave	anëtar
Një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit	anëtar
Një përfaqësues i Drejtorisë së Patentave dhe Markave	anëtar
Një përfaqësues i Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit	anëtar
Një përfaqësues i Komisionit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	anëtar

Një përfaqësues i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të

Pasurive të Paluajtshme

anëtar

3. Anëtarët e grupit negociator shqiptar janë përgjegjës për ndjekjen dhe bashkërendimin e detyrave në ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse për realizimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Komisionin Europian dhe shtetet anëtare të Bashkimit Europian.

4. Ministri i Shtetit për Integrimin, në cilësinë e kryenegociatorit, nëpërmjet Departamentit të Integritetit në Këshillin e Ministrave, bashkërendon punën e institucioneve përgjegjëse për realizimin e detyrimeve, në kuadër të hapjes së negociatave dhe të nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Komisionin Europian dhe shtetet anëtare të Bashkimit Europian.

5. Anëtarëve të grupit negociator shqiptar u jepet një shpërblim mujor deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë, fond i cili përballohet nga buxhetet vjetore të ministrive dhe institucioneve qendrore përkatëse. Masa e shpërblimit mujor përcaktohet me urdhër të ministrit apo të drejtuesve të institucionit qendror përkatës, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Integrimin.

6. Kriteret për përzgjedhjen e negociatorëve, përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, kompetencat e grupit negociator, mënyra e funksionimit të tij dhe marrëdhëniet me të tretët përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Integrimin.

7. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore të lartpërmendura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko